



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia Org. Org. Unit	AEPL	Nr. i Prot. Prot. No	2794-2/23
Nr. i Faqeve No. Pages	04	Data: Date:	15.04.24
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	05.03.2024
REFERENC-Ë:	2794/23 - ZSP- 2024
PËR/ZA/TO:	„KORAL CORPORATION” Sh.p.k. F.Kosovë Rr. Nënë Teresa, Zona Agroindustriale
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvëndësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvëndësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv, me Nr.të protokollit: 2794/23, datë 25.05.2023, parashtruar nga „KORAL CORPORATION” Sh.p.k., K. F.Kosovë dhe ka vendosur si në Ndryshim Vendim për Leje Ujore, nga “SOLE KOSOVA ” SH.P.K. , K. F. Kosovë në “KORAL CORPORATION” Sh.p.k. në F.Kosovë, të bashkangjiur kësaj shkresë pëcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalvog Sekretara / Office of the General Secretary

LU


Datë: 05.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „ **KORAL CORPORATION**” Sh.p.k., K. F.Kosovë, me Nr.protokoli 2794/23, datë 25.05.2023, për bartje të lejes ujore, për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor nga Puset, për nevojat e therrores, nga “**Sole Kosova**” Sh.p.k. K. F.Kosovë, në “**KORAL CORPORATION**” Sh.p.k. K.F.Kosovë, nën kushtet vijuese:

1. Pala duhet ti përmbahet të gjitha kushtet të lejes ujore, me Nr. : 6058/22-ZSP , 2022, datë 17.10.2022, për shfrytëzim të ujërave nëntokësor nga Pusi 1 & Pusi 2.




ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Legjislacionin për Ujërat e Kosovës, bazuar në kushtin me nr. 11 të vendimit për leje ujore, me Nr. 6058/22 - ZSP- 2022, datë 17.10.2022; Bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur: Pagesa e tarifës me nr. Fat.001161 sipas shtojcës 6 të U.A.03/2018, për bartje të Lejes Ujore; Certifikata e regjistrimit të biznesit (810492629) Sole Kosova, dhe Certifikata e regjistrimit të biznesit me emrin “Koral Corporation” Sh.p.k. , me nr. e njejët (810492629); Vërtetimin nga ARBK-ja, lidhur me ndryshimin e emrit të biznesit nga “Sole Kosova “ në “Koral Corporation”; Kopje e Vendim të lejes ujore – shfrytëzim , me Nr: Protok 6058/22 –ZSP- 2022, datë 17.10.2022. Andaj bazuar në at se :

- “Sole Kosova” ka poseduar Leje ujore, e Nr: Protok 6058/22 –ZSP- 2022, datë 17.10.2022;
- Kërkesës për ndryshim të emrit nën kushtet e njejëta të lejes ujore paraprake nga “Sole Kosova “ sh.p.k. në “Koral Corporation” sh.p.k.;
- Vërtetimit për ndryshim të emrit nga “Sole Kosova “ në “Koral Corporation” nga ARBK, me nr protokoli 133 , datë 06.03.2023 i cili e posedon edhe numrin e njejët të certifikates së biznesit si më parë,
- Shikimit në vend nga zyrtar të ARPL-së, ku edhe është mbajtur procesverbali i nënshkruar nga Pala dhe Zyrtar të ARPL-së, me datë 01.02.2024;
- Pagesës së bërë me rastin e aplikimit për ndryshim të emrit, sipas shtojcës 6 të “U.A. 03/2018 për procedurat për Leje Ujore” në vlerë prej 200 €; Andaj bazuar në të dhënat si më sipër është vendosur si në vendim të lejes Ujore për “Koral Corporation” dhe pala duhet të i përmbahet të gjitha kushteve të lejes ujore paraprake, me që vetëm emri është ndryshuar dhe kushtet mbesin të njejëta për palën.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 2794/ 23 - ZSP - 2023, datë: 05.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës F. Kosovë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

